



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

KODI I ETIKËS

RIORGANIZUAR



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E LËNDËS

1.	Preambula.....	3
2.	Kreu I Rregullat e sjelljes.....	6
3.	Kreu II Rregullat e etikës për anëtarët e Stafit Akademik	11
4.	Kreu IV Rregullat e etikës për administratën institucionale.....	12
5.	Kreu V Rregullat e etikës për studenët e Albanian University.	13
6.	Kreu VI Dispozita Zbatuese.....	15
7.	Proçedurat Disiplinore.....	16



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

Preambula

Albanian University, pwrfaqwson njw organizwm kompleks, anwtarwt e tw cilit kanw formime tw ndryshme, mbulojnw role dhe pwrgegjwsi tw caktuara si dhe zhvillojnw marrwdhwnie tw shumwllojshme. Ekzistenca e njw komuniteti nwnkupton jo vetwm njohjen dhe respektimin e tw drejtave individuale të anwtarwve, por edhe pranimin dhe marrjen pwr sipwr tw detyrave dhe pwrgegjwsive ndaj universitetit, tw gjithw anwtarwve tw tij dhe ndaj kolektivitetit.

I vetwdijshem pwr funksionin e rwndwsishwm social dhe formues qw kanw Insitucionet e Arsimit tw Lartw, universiteti pasqyron vlerat qw tradicionalisht qwndrojnw nw themel tw mwsimdhwnies, kwrkimit shkencor dhe veprimtarive tw tjera universitare.

Universiteti frymwzohet nga kwto vlere pwr tw garantuar prestigjin dhe emrin e tij tw mirw, krijimin e njw ambjenti tw hapur ndaj dialogut dhe tw orientuar drejt marrwdhwnieve korrekte profesionale dhe ndwrpersonale, hapjen ndaj shkwbimeve me komunitetin shkencor kombwtar dhe ndwrkombwtar, formimin e individit nw tw gjitha aspektet e mundshme.

Kodi etik përfaqëson frymwn dhe bashkwsine e parimeve tw sjelljes dhe tw kriterëve qw orientojnw veprimtarinw e anwtarwve tw komunitetit universitar.

Pedagogwt, kwrkuesit, personeli teknik-administrativ, studentwt, si dhe çdo anwtar tjetër i universitetit, gjatw pwrmbushjes se detyrave dhe nw kuadwr tw roleve e pwrgegjwsive qw mbulojnw, individualisht apo kolegjalisht, duhet tw respektojnw, mbrojnw dhe pwrkrahin vlerat themelore tw:

Institucioneve tw Arsimit tw Larte dhe veçanwrisht:

- a)** ndalimi i çdo diskriminimi të padrejte;
- b)** dinjiteti njerëzor;
- c)** vleresimi sipas kriterit tw aftesise;
- d)** vleresimi dhe respekti ndaj veçorive individuale dhe kulturore;
- e)** pwrgegjqësia dhe njohja e detyrave ndaj komunitetit universitar;
- f)** ndershmeria, integriteti dhe profesionalizmi;
- g)** dija, cilwsia e lartw, pwrkrahja e studimit dhe e kwrkimit shkencor;
- h)** barazia, paanshmeria, bashkwpunimi i ndershwme dhe transparenca.

Vlerat e shprehura nw kwtw preambul pwr caktojnw standartet e zbatueshwme tw sjelljes pwr sa i perket interpretimit tw çështjeve etike të përcaktuara në këtë kod, dhe të çështjeve të tjera që lidhen me veprimtarine e jetës universitare.

Ky kod etik nuk zëvendëson ligjin, por integron dispozitat normuese te zbatueshme



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

pwr anwtarwt e komunitetit universitar. Ai do tw shwrbejw si udhwzues pwr tw gjithw stafin e “Albanian University” dhe studentet lidhur me veprimtarinw e pwrditwshme apo me ato vendimarrwse nw lidhje me misionin, parimet dhe vlerat themelore. Kodi etik shërben edhe si një mjet për të inkurajuar diskutimet lidhur me etikwn dhe për të përmirësuar qëndrimet apo reagimet në punën akademike brenda institucionit dhe qwndrimet jashtë tij.

Qëllimet e “Albanian University” kërkojne që gjithkush, që punon për këtë institucion, të respektojw apo tw zbatojw standartet mw tw larta të etikws dhe nga ana tjetwr studentwt të ndjekin si antarë të ketij komuniteti rregullat etike te sjelljes.

Moszbatimi nga studentet i rregullave të kërkuara në këtë Kod dhe i rregullave përben arsye për ndwmarjen e masave disiplinore nga organet drejtuese të Universitetit, referuar nenit të Rregullores dhe nenit tw Statutit të Albanian University. Në raport me shkeljet e konstatuara e të verifikuara nga Keshillit të Etikes do të ketë edhe masat e parashikuara nw Rregulloren e Universitetit deri nw pwrfundimin e marrwdhwnieve me universitetin.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Kreu I

Rregullat e sjelljes

Neni 1

Ndalimi i çdo diskriminimi të padrejtë

1. Të gjithë anëtarët e universitetit kanë të drejtë të trajtohen në mënyrë të barabartë, dhe të mos diskriminohen padrejtësisht, në mënyrë të shprehur ose tërthorazi, për shkak të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore, pamja fizike kombëtare, orientimi seksual, kushtet personale dhe shëndetësore, shtetëzëria, zgjedhjet familjare, mosha. Diskriminimi është i shprehur kur për të paktën një nga arsyt e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, një individ trajtohet në mënyrë më pak të favorshme.

2. Diskriminimi është i tërthortë kur një dispozitë, një kriter ose një praktikë në dukje e paanshër, mund të vendosin në pozicion jo të favorshëm, kategori personash të identifikuar sipas faktorëve të renditur në paragrafin 1 të këtij neni, përveçse kur dispozita, kriteri apo praktika justifikohen objektivistikisht nga një qëllim i ligjshëm, dhe mjetet e përdorura për realizimin janë të duhura dhe të nevojshme.

3. Universiteti nuk pranon dhe ndërmerr masat e nevojshme për të mos inkurajuar sjellje diskriminuese ose cënuesë, ndaj një anëtarit të komunitetit universitar gjatë punës, nga subjekte të caktuara në pozicion hierarkik më të lartë ose nga kolegë, sjellje të cilat materializohen në formën e persekutimit psikologjik ose të dhunës morale të tilla që përkeqësojnë kushtet e punës, ose kompromentojnë shëndetin, profesionalizmin, ekzistencën ose dinjitetin e anëtarit.

4. Universiteti refuzon çdo formë paragjykimi të paarsyeshëm shoqëror, çdo ngacmim të bërë për një nga arsyt e përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni, çdo praktikë diskriminuese, degraduese, poshtëruese, apo ide superioriteti moral të një grupi krahasuar me grup tjetër. Është detyrë e universitetit dhe e anëtarëve të tij të inkurajojnë iniciativat, të përkrahin mbrojtjen dhe vlerësimin e kategorive të pafavorizuara, diversitetin individual dhe kulturor.

Neni 2

Liria dhe dinjiteti personal

1. Anëtarët e komunitetit universitar duhet të:

a) evitojnë çdo sjellje, që mund të rezultojë fyese apo cënuesë, ose të mund të dëmtojnë, edhe tërthorazi, nderin dhe emrin e kolegëve, bashkëpunuesve, mësuesve, studentëve dhe kujtdo tjetër, që ka marrëdhënie me strukturat universitare;



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

b) evitojnë çdo lloj sjelljeje që, falë autoritetit që vjen nga pozicioni përkatës, mund të shkaktojë ndryshime të padrejtë në ushtrimin e detyrave që janë përgjegjësi e subjekteve të tjerë.

Neni 3

Liria akademike

1. Universiteti impenjohet të krijojë një ambient që favorizon idealin e lirisë dhe autonomisë individuale, të nënkuptuar si parakushte të domosdoshme të studimit, profesionalizmit, kërkimit në fushë me të gjere, eksplorimit intelektual dhe realizimit të dijes.

2. Në ushtrimin e lirise akademike, anetaret e universitetit kanë për detyrë të mbajnë sjellje të ndershme dhe të përgjegjshme, edhe nëpërmjet veterregullimit dhe vecanerisht:

- a) të perkrasin lirine e mesimit duke shmangur cdo sjellje qe mund ta kushtezoje ate;
- b) të favorizojnë zgjedhjen e profileve të ndryshme vecanerisht ato kerkimore. duke evituar cdo sjellje nderhyrese ne veprimtarine shkencore te anetareve te tjere te komunitetit universitar;
- c) të favorizojnë, në rastin e kerkimeve kolektive, menyra korekte të rezultateve të haritura që evidentojnë dhe deklarojnë kontributin e secilit pjesëmarrës
- d) të evitojnë krijimin e pengesave për kalimin e kerkuesve nga një strukturë në tjetren;
- e) të zhatojnë rigorozisht rregullat në fushën e' pronësive intelektuale, në lidhje me .menyren e publikimit të rezultateve të studimeve dhe kerkimeve, duke i dhënë rendesine e duhur rezultateve të arritura nga të tjerë kerkues dhe studiues;
- f) të mos përdorin për qëllime private dhe personale rezultate të arritura nëpërmjet veprimtarisë së kërkimit universitar;
- g) të shmangin cdo lloj sjellje që; mund të. pengojë ushtrimin e plotë të të drejtës për arsim të studenteve, në kuadrin e programeve mësimore të stimuluar nga universiteti për rezultate të larta të studimeve universitare;
- h) të shpallim burimin e financimeve të mundshme që janë përdorur për publikimet dhe kërkimet.

3. Anetaret e universitetit kanë gjithashtu për detyrë, të mbajnë një qëndrim bashkëpunimi dhe respekti ndaj vendimeve akademike me karakter organizues, të nxjerra për qëllime efikasiteti, barazie, përpikërsie dhe transparence të administratës universitare.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

Neni 4

E drejta e autorit dhe e shfrytëzimit dhe riprodhimit të veprës

- 1.** Përvetëse kur parashikohet ndryshe, anëtarët e komunitetit universitar kanë për detyrë të respektojnë normat mbi të drejtën e autorit, të shfrytëzimit dhe të riprodhimit të veprës.
- 2.** Autori i një veprë intelektuale që i përket universitetit, ka për detyrë të mos e perdorë për qëllime private, dhe të ruajë sekretin mbi rezultatet e arritura prej saj deri në momentin e publikimit zyrtar.
- 3.** Bazuar në rolin e rëndësishëm shoqëror të kërkimit shkencor, universiteti, mbrohet idetë se rezultatet përkatëse duhet të kontribuojnë në zhvillimin e mirëqenies së komunitetit; pronësia intelektuale presupozohet për këto arsye në favor të universitetit.
- 4.** Veprimtaritë akademike me rëndësi shkencore që zhvillohen kolektivisht, duhet të përcaktojnë specifikisht, se cilit pjesëmarrës i referohen pjesët specifike. Për secilin grup, është detyrë e koordinatorit:
 - a)** të promovojë kushtet që secili pjesëmarrës të mund të veprojë sipas parimeve të integritetit, ndershmërisë, profesionalizmit dhe lirisë;
 - b)** të vlerësojë meritat individuale dhe të identifikojë përgjegjësitë për secilin pjesëmarrës;
 - c)** të nxirë dialogun, bashkëpunimin, kritikën, argumentimin, zhvillimin e ideve dhe të aftësive personale, sidomos në zhvillimin e veprimtarive shkencore të ngjashme ose që kërkojnë një përafrim metodologjik kompleks dhe/ose multidisiplinor.

Neni 5

Konflikti i interesave

- 1.** Ekziston konflikt interesash kur interesi privat i një anëtar të universitetit, me përjashtim të studentit, bëhet realisht ose potencialisht në kundërshtim me interesin, jo vetëm ekonomik, të universitetit. Ky konflikt ka të bëjë edhe me raportet e jashtëme të punës me subjekte të formimit ose institucione të arsimit të lartë potencialisht konkurrues.
- 2.** Interesi privat, me natyrë jo vetëm ekonomike i një anëtar të universitetit mund të lidhet me:
 - a)** interesin e drejtperdrejtë të personit, në cilësinë e anëtarit të universitetit;
 - b)** interesin e një të afërmi të një anëtar të universitetit;
 - c)** interesin e subjekteve, personave fizike ose juridike me të cilët anëtarët e universitetit kanë marrëdhënie pune, të natyrës ekonomike ose financiare;
 - d)** interesin e të tjerëve, kur në mënyrë të vetedijshme mund t'i sjellin avantazhe anëtarit të universitetit.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

3. Anetari i universitetit (qe ne nje veprimtari apo rrethane te caktuar ka interesa ne konflikt me ato to vete universitetit, duhet te jape njoftim te menjehershem organit ose personit pergjegjes ose hierarkisht me lart, ose duhet te mos marre pjese ne vendime te mundshme merite.

Neni 6

Nepotizmi dhe favorizimet

1. Universiteti nuk toleron fenomenet e nepotizmit dhe favorizimit, qe vijne ne kundërshtim me dinjitetin njerezor, me vleresimin e aftesive dhe meritave individuale, me parimet e ndershmerise, integritetit, profesionalizmin, lirise akademike, barazise, paanshmerise dhe transparencen. Personeli akademik dhe cdo anetar tjeter i universitetit duhet te shmange te tilla praktika dhe t'i referoje Keshillit te Etikes ne raste sjelljesh te dyshimta.

2. Behet fjale per nepotizem kur nje pedagog, nje kerkues, ose nje anetar i personelit teknik-administrativ drejtperdrejt ose terthorazi edhe nepermjet burimeve te jashtme perdorin autoritetin e tyre ose aftesine per te bindur per te dhene perfitime, per te favorizuar poste ose detyra, per te influencuar mbi rezultatet e konkurseve ose mbi procedurat e perzgjedhjes qe lidhen ne menyre te vecante por jo vetem me fazen fillestare te formimit te karrieres universitare (bursa studimi, kontrata, etj.).

4. Ne rastin e karrieres akademike nepotizmi presupozohet ne rastet kur:

- a) mes sektorit shkecor-disiplinor te mbrojtjes dhe te mbrojturit ka ngjashmeri ose perputhje; dhe/ose
- b) i mbrojturi duhet te zhvilloje veprimtarine e tij ne fushen e te njejtit departament te mbrojtjesit.

4. Konsiderohen njelloj me nepotizmin praktikat e favorizimit te nje profesori kundrejt nxenesve te tij, ne kuptimin e sjelljeve te padrejta qe bien ne kundërshtim me emrin e mire te universitetit, me vlere si ndershmeria dhe paanshmeria, si dhe me interesin e kandidateve te tjere te merituar dhe te shkelqyer ne fillim ose gjate fazave te metejshme te ecurise akademike.

5. Ne vertetimin e rasteve te nepotizmit dhe favorizimit, Keshilli i Etikes duhet te konsideroje kontekstin dhe rrethanat, me qellim qe te ruhet ekuilibri i vlerave te ndryshme qe jane ne loje si dhe qe te evitohen diskriminime te padrejta te kandidateve qe jane te merituar dhe te shkelqyer.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

Neni 7

Abuzimi i detyres

1. Asnje anetar i universitetit nuk mund te ushtroje, drejtperdrejte ose jo, autoritetin qe ka fale pozicionit te vet akademik ose fale zyres *se* tij, per te detyruar anetaret e tjere te universitetit qe te kryejne veprime ose sherbime avantazhuese per te paret, pervec rasteve kur veprimet ose sherbimet perbejne detyrim juridik te te dyteve. Abuzimi mund te verifikohet edhe nepermjet sjelljesh qe edhe pse nuk jane te kundraligjshme, jane qartesisht ne kundershtrim me shpirtin e normave dhe rregulloreve te universitetit.

Neni 8

Perdorimi i burimeve te universitetit

1. Anetaret e universitetit duhet te perdorin burimet e vena ne dispozicion nga universiteti me pergjegjesi dhe kujdes ne menyre qe te mund te justifikojne shpenzimet dhe te sigurojne dokumentacionin e duhur ose te raportojne me kerkese te universitetit.
2. Asnje anetari nuk i lejohet te perdore ose t'u jape personave apo subjekteve te jashtem mjete kerkimi, hapesira apo burime nerezore, materiale ose financiare te universitetit per qellime personale dhe/ose per qellime të ndryshme nga ato te universitetit, perveçse kur është autorizuar shprehimisht.

Neni 9

Perdorimi i emrit dhe i reputacionit te universitetit

1. Te gjithë anetaret e komunitetit universitar kane per detyre te respektojne emrin e mire dhe te mos cenojne reputacionin e institucionit.
2. Perveçse kur ka autorizim me shkrim, asnje anetar i universitetit nuk mund të:
 - a) perdorë në menyre të papërshtatshme shenjat dalluese dhe emrin e universitetit;
 - b) te perdore emrin e universitetit në shoqata dhe aktivitete profesionale, pune, impenjime ose te tjera aktivitete te jashtme/te huaja, edhe te natyres jo fitimpruese;
 - c) te shprehe ne emrin dhe per llogari te universitetit kendveshtrime te natyres personale.

Neni 10

Dhurata dhe perfitime

1. Anetara e universitetit kane per detyre te mos nxisin dhe te refuzojne çdo lloj oferte jo siinbolike dhuratash ose perfitimesh qe mund te ndikojë, edhe jo drejtperdrejte, zhvillirnin e veprimtarive universitare.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

2. Anetaret mund të pranojnë oferta, vullnetare dhuratash ose përfitimesh me vlerë simbolike gjatë takimeve kulturore, vizitave ose konferencave shkencore publike, dhe gjithmonë kur pranimi nuk ndikon, në zhvillimin e veprimtarive universitare.

Neni 11

Informacione të rezervuara

1. Të gjithë anetaret e universitetit kanë për detyrë:

- a) të respektojnë sekretin e personave ose subjekteve për të cilët universiteti mban informacione të mbrojtura;
- b) të ruajnë sekretin e zyres, të dhënat e mbrojtura ose informacione me karakter të rezervuar që janë marrë gjatë përmbushjes së detyrave institucionale, përhapja e të cilave me çdo formë publikimi zyrtar, është e tillë që cenon padrejtësisht interesin e universitetit dhe/ose të tretëve.

Neni 12

Arsyetimi i vendimeve

1. Anetaret e universitetit kanë për detyrë që gjithmonë të arsyetojnë objektivisht vendimet e rëndësishme, përfshirë ato që influencojnë mbi pozicionin ose karrierën e anetareve të tjera të universitetit, si dhe ato që kanë për objekt përshkrimin ose promovimin e veprimtarive formuese.

Neni 13

Marreveshjet e bashkepunimit

1. Në bazë të nenit 47 të statutit, universiteti mund të lidhë marreveshje me subjekte publike dhe private, vendase dhe të huaja, për bashkepunim dhe bashkeveprim akademik dhe shkencor si dhe për aktivitetet me interes të përbashkët, në përputhje me parimet e transparencës, publicitetit, autonomisë dhe etikës.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

RREGULLAT E ETIKES PER ANETARET E STAFIT AKADEMIK

KREU II

Neni 14

Standartet baze te sjelljes

Parimet bazë të sjelljes

- 1.** Anëtarët e stafit akademik duhet të ndjekin dhe të respektojnë standardet më të larta të të vepruarit etik. Ata duhet të veprojnë me profesionalizëm dhe të vënë në dispozicion të veprimtarisë mësimore njohuritë e tyre teorike dhe praktike me seriozitet dhe paanshmëri.
- 2.** Anëtarët e stafit akademik duhet të trajtojnë me mirësjellje dhe me respekt kolegët e tyre, administratën institucionale dhe studentët. Ata duhet që nëpërmjet sjelljes së tyre të motivojnë punën dhe përkushtimin e stafit për kryerjen sa më mirë të përgjegjësive të marra.
- 3.** Anëtarët e stafit akademik duhet të marrin parasysh karakterin e funksionit të tyre dhe të sillen në mënyrë të tillë që të ruajnë dhe të nxisin besimin tek studentët dhe grupet shoqërore lidhur me ta. Ata duhet të jenë të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë që kanë në edukimin dhe arsimimin e brezave që arsimohen.
- 4.** Stafi akademik duhet të jetë i pavarur në përzgjedhjen e metodikave të përmbushjes së funksionit të tyre të cilat duhet të jenë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe rregullores së brendshme të Albanian University.

Kreu III

Neni 15

Marrëdhëniet me studentët

Pedagogu:

- 1.** Respekton mendimet e dhëna prej çdo studenti (në çdo cikël studimi), autonominë dhe dinjitetin e tij.
- 2.** Respekton personalitetin e studentit pavarësisht moshës, racës, bindjeve fetare, përkatësisë gjinore etj.
- 3.** Në emër të etikës profesionale është i detyruar të ndihmojë, mbështesë apo këshillojë studentin nëse është e nevojshme në lidhje me procesin arsimor.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

4. Ka detyrimin të sigurojë cilësinë më të lartë të mësimdhënies për të nxitur madje studentët drejt shfrytëzimit maksimal të vlerave të tyre personale dhe intelektuale, arritjen e rezultateve të larta akademik dhe nivel të lartë kualifikimi.
5. Ka detyrimin të jetë i drejtë dhe i paanshëm në vlerësimin e dijeve të marra prej arsimimit dhe të mos lejojnë objektiviteti i vlerësimit të cenohet si rrjedhojë e influencimit të faktorëve të jashtëm.

Neni 16

Paraqitja në punë, mirësjellja dhe respekti

Paraqitja e studenteve në punë duhet të jetë përshtatshme dhe e tillë që të shprehë:

- a)** Kujdesin dhe seriozitetin e vazhdueshëm për anën e tyre pamore;
- b)** Nivelin e domosdoshëm të pastërtisë së tyre personale;
- c)** Plotësimin e kërkesave të domosdoshme të veshjes së tyre në ambientet e universitetit; Veshja duhet të shfaqë seriozitetin e statusit dhe në përputhje me qëllimin e pjesëmarrjes së studentit në procesin mesimor;
- d)** Vëmendje në mënyrën e komunikimit dhe të qëndrimit në ambientet e institucionit.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

RREGULLAT E ETIKES PËR ADMINISTRATËN INSTITUCIONALE

KREU IV

Neni 17

Standartet baze te sjelljes

- 1.** Anëtarët e administratës së institucionit kërkohet që të zbatojnë standartet më të larta të sjelljes etike në përputhje me vlerat e integritetit, të paanshmërisë dhe të maturisë. Gjatë kryerjes së detyrës së tyre ata janë të detyruar t'i qëndrojnë mbi të gjitha besnik universitetit, objektivave, qëllimeve dhe parimeve të aktivitetit të tij.
- 2.** Albanian University respekton intimitetin e personelit administrativ dhe nuk dëshiron që të ndërhyjë në jetën tyre personale apo në sjelljet e tyre brenda dhe jashtë vendit të punës. Sidoqoftë, statusi personelit të administratës ka si pasojë disa detyrime lidhur me sjelljen tyre, si në punë ashtu edhe jashtë saj. Universiteti i kushton rëndësi të madhe zbatimit, nga ana e tyre të të gjitha akteve ligjore e nënligjore në fuqi, sikurse edhe shmangies së veprimeve që mund të perceptohen si shpërdorim i prestigjit që ka institucioni dhe stafi i saj akademik.
- 3.** Sjellja zyrtare duhet të karakterizohet gjithnjë nga objektiviteti dhe profesionalizmi. Anëtarët e administratës nuk duhet të lejojnë që marrëdhëniet apo konsideratat personale, përshirë këtu edhe paragjykimet, njëanshmëritë apo favorizimet, të ndikojnë rezultatet e detyrave zyrtare. Njëlloj duhet të shmangen edhe situatat që krijojnë konflikte interesash.
- 4.** Stafii administratës gjithmonë nuk duhet të dal jashtë autoritetit që ju jep funksioni. Ata mbeten përgjegjës për detyra që i delegojnë të tjerëve dhe pritet që të ushtrojnë mbikëqyrje dhe kontroll të përshtashëm mbi gjithçka që lidhet me detyrën e tyre.
- 5.** Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Albanian University, administrata institucionale ka përgjegjësinë që, burimet e institucionit t'i vërë në përdorim vetëm për realizimin e detyrave zyrtare të saj. Gjithashtu, në funksion të përdorimit sa më efikas të burimeve që i janë vënë në dispozicion, ajo duhet që t'i kushtoj kohën e punës vetëm aktiviteteve zyrtare të Universitetit.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

RREGULLAT E ETIKES PER STUDENTET E ALBANIAN UNIVERSITY

KREU V

Kodi i etikes eshte nje teresi normash qe synon qe te gjithë studentet e universiteti te ndajne se bashku nje pergjegjesi kolektive per te ruajtur standartet e nje etike te larte profesionale si ne raportet e maredhenieve me njeri tjetrin ashtu edhe me stafin dhe te tjere:

Studentët e Albanian University përfaqësojnë rezultatin akademik dhe ata kanë detyrimin etik të nxiten drejt arritjeve të larta në mësimdhënie dhe vendosmëri për përmbushjen me sukses së kualifikimit profesional.

Me qëllim që të krijojme dhe ruajme ambientin me te mire te mundshem, eshte e nevojshme qe studentet t'i permbahen standarteve te profesionalizmit, miresjelljes dhe etikes. Miresjellja dhe respekti i gjithsecilit jane esenciale per të rritur edukaten dhe për të ulur keqkuptimet. Cdo student duhet të njohe pergjegjesine e tij morale e profesionale dhe te ruaje traditen e respektimit me korektese te normave te kodit etik qe të shkoje drejt ngritjes sa me lart të përgatitjes se tyre profesionale.

Neni 18

Standartet etike te sjelljes se studenteve

Studentet duhet :

- 1.** Te përmbushin detyrimet e tyre akademike me ambientin për të ndjekur zhvillimin intelektual të nevojshëm për realizimin me sukses të tyre;
- 2.** Te krijojnë dhe ruajnë marrëdhëniet me bashkë studentët e tjere, ngritur me mbi etikën e statusit të studentit, ndershmërisë, respektit reciprok dhe mungesës së paragjytimeve;
- 3.** Te ruajnë prestigjin dhe emrin e mirë të rrethit akademik brenda dhe jashtë institucionit;
- 4.** Te zbatojnë me përpikëri detyrimet për një proces mësimor rezultativ, parashikuar në rregulloren e institucionit;
- 5.** Te zbatojnë etikën e marrëdhënieve me pedagogët të rregulluar në Kreun III të këtij kodi duke respektuar dijet dhe personalitetin e pedagogut, duke shprehur me kurajo e korektese mendimet e tyre në mënyrë adekuate brenda dhe jashtë auditorit;
- 6.** Te mos bejne sjellje te pahijshme ndaj stafit dhe studenteve te tjere.Kritikat duhet te jepen ne nje vend privat;



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

7. Te kuptojne qe cdo forme e shqetesimit lidhur me racen, seksin, ngjyren, fene, moshen ,origjinen, kushtet shendetesore konsiderohet jo etike;
8. Te respektojne te drejtat dhe sigurine e personave te tjere ne shkolle
9. Te adresojne mosmareveshjet ndermjet shkolles dhe studentit tek nje person pergjegjes, pa anshkaluar hallkat hierarkike te zgjidhjes se situates.
10. Të vetëpërbahen ndaj çdo veprimi që mund të çënojë autoritetin e tyre.

Studentet nuk duhet të:

11. Zoterojne apo te perdorin arme zjarri ose arme te ftohta brenda teritorit te Universitetit;
12. Zoterojne ,te perdorin apo shesin ne menyre ilegale droga brenda apo jashte Universitetit;
13. Marrin pjesë në tentativa për mashtrim ose çënim të rregullave të procesit akademik;
14. Paraqesin punime te shkruara ,laboratorike,apo projekte si te tijat kur e dine se ato jane te nje personi tjetër;
15. Te pervetesojne,te shkateroje pronen e shkolles apo te dikujt tjetër ;
16. Te bejne presion,te kercenoje,te abuzoje ose sjellje te ngjashme me keto perkundrejt nje personi, i cili eshte i ngarkuar me detyren per t'i thene keto para Keshillit te etikes;
17. Te fshehin prova ose te jape prova fallso rreth nje ankese etike dhe profesionale, e cila eshte pare dhe hetuar;
18. Te veprojne në një mënyre ne nje menyre, e cila indirekt interferon ne mesimdhënien e shkolles,kerkimin apo administrimin e saj.

Neni 19

Paraqitja në shkollë, mirësjellja dhe respekti

Paraqitja e studentit në auditorë duhet të jetë përshtatshme dhe e tillë që të shprehë:

- e) kujdesin dhe seriozitetin e vazhdueshëm për anën tuaj pamore;
- f) nivelin e domosdoshëm të pastërtisë tuaj personale;
- g) plotësimin e kërkesave të domosdoshme të veshjes tuaj në ambientet e universitetit; Veshja e studentëve duhet të shfaqë seriozitetin e statusit dhe përputhje me qëllimin e pjesmarjes së studentit në procesin mësimor;
- h) vëmendje në mënyrën e komunikimit dhe të qëndrimit në ambientet e institucionit.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

KREU VI

Dispozita zbatuese

Neni 20

Respektimi dhe shkelja e kodit te etikes

1. Ne perputhje me percaktimet ne preambul dhe ne Kreun I – V, eshte detyre e pedagoqeve, kerkuesve, personelit teknik-administrativ, studenteve dhe e cdo anetari tjetër te universitetit qe:

- a) to njohin kete kod dhe praktikak interpretuese;
- b) to familjarizohen me rregullat e sjelljes to percaktuara ne kete kod dhe qe lindin nga praktikak interpretuese;
- c) t'i drejtohen Keshillit te Etikes per te marre keshillim per zbatimin e ketij kodi ose sjelljen e pershtatshme ne lidhje me ceshtje te percaktuara nga ky kod;
- d) to respektojne kete kod dhe praktikak interpretuese.

2. Keshilli i Etikes ngrihet prane universitetit dhe funksionon ne baze te percaktimeve te bera ne nenin 23 te Statutit te Albanian University.

3. Keshilli i Etikes i cili pasi shqyrton ankesat per shkeljet e normave te Kodit Etik,dhe ato te parashikuara ne Rregulloren e Universitetit ne nenin 51 te tij,merr masat e parashikuara apo jep rekomandime ne vartesi nga shkelja e kryer.

4. Keshilli i Etikes, ne ushtrimin e funksioneve te veta, mund te kerkoje mbeshtetjen e zyrove administrative te universitetit si dhe mund te shfrytezoje keshillimin e specialisteve te caktuar nga vete Keshilli.

5. Anetaret e Keshillit te Etikes dhe ata qe e asistojne, kane per detyre te respektojne sekretin lidhur me ceshtje per te cilat marrin dijeni per shkak te detyres se tyre.

6. Vendimet e Keshillit te Etikes duhet te jene te arsyetuara.

Neni 21

PROCEDURAT DISIPLINORE

Procedurat disiplinore qeverisin disiplinën e cdo antari te komunitetit universitar qe e rregullon Kodi i Etikes qe akuzohen per shkeljen e e ketij kodi dhe konsistojne si me poshte:

A. Ankesa

Ankesa eshte nje shkrese qe i drejtohet Kryetarit te KE qe nje shkelje e normave te Kodit Etik mund te jete shfaqur dhe qe Keshilli duhet ta shqyrtoje, por me pare Kryetari ngarkon te hetoje mbi kete ceshtje nje komision . Çdo i punesuar student apo anetar i shkolles mund te beje nje



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

ankese. Ankesa duhet te raportohet si shkrese tek Kryetari i Keshillit te Etikes dhe ky ja percjell ate Kryetarit te Komisionit te incidenteve brenda dy javeve nga incidenti .Ne kete ankese duhet te pershkruhen te gjitha faktet lidhur me shkeljen e normave te Kodit Etik. Gjate kohes se hetimit mbi ceshtjen studenti apo cdo i punesuar ne universitet, mund te mos pezullohet per vazhdimin e procesit mesimor apo programit shkollor.

B. Hetimi dhe sqarimi nga Komisioni i Incidenteve

Pasi merret ankesa e shkruar Kryetari i Komisionit te Incidenteve brenda pese ditesh pune do te:

1. Te filloje hetimin me se pakti prezencen e tre anetareve te ketij Komisioni.
2. Te hartoje nje shkrese te studentit apo te punesuarit ne universitet te akuzuar me daten, kohen, vendin e incidentit, me deshmine dhe evidencat perkatese.
3. Dokumenti qe i jepet antarit te komunitetit te universitetit te akuzuar gjithashtu duhet te permbaje si me poshte:
 - a. nje shkrese te ankeses
 - b. nje shkrese e cila informon studentin qe ai ose ajo mund te zgjedh prezencen ose jo te tij gjate shkrimit;
 - c. Listen e deshmitareve te cilet do te parashtrojne provat qe mbeshtesin ankesen;
 - d. Listen e gabimeve nga ana e studentit apo te punesuarit nese ai eshte fajtor.

Ankuesi i thirrur si deshmitar do t'i paraqese komisionit ne seancat e degjimit te dokumentave, prova ose deshmitar te tjere te cilet ai i mendon se kane lidhje me ankesen qe ka parashtuar.

Studenti apo i punesuari ne kete universitet ndaj te cilit eshte paraqitur ankesa, mund te mos kete avokat present, por mund te kete nje anetar te shkolles ose student tjetër ne rolin e keshilltarit apo per mbeshtetjen emocionale. Ai mund te parashtroje te gjitha provat, deshmitaret apo dokumentacionin qe jane ne favor te tij Komisionit te Incidentit (KI). KI mund te pyesi te gjithë deshmitaret i pavarur nga rregullat e deshmitareve qe zbatohen normalisht ne gjykimet qe zhvillojne gjykatat. Nuk mbahet protokoll, por sekretari i KI mund te shenoje disa gjera te permbledhura. Si perfundim KI i dergon nje rekomandim te shkruar kryetarit te Keshillit te Etikes dhe nje vote mazhoritare eshte e mjaftueshme per te dale ne nje perfundim.

C. Rekomandimet e mundshme te Komisionit te Incidenteve

1. Studenti nuk ka vepruar ose nuk ka deshmi te mjaftueshme qe ai ka vepruar ne menyre jo etike;
2. Studenti ka vepruar ne menyre jo profesionale dhe jo etike dhe ai duhet te keshillohet me Kryetarin e Keshillit te Etikes;
3. Studenti ka kryer nje veper jo etike dhe jo profesionale dhe kjo duhet t'i bashkangjitet dosjes se tij deri ne diplomimin e tij.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Kryetari i Komisionit të Incidenteve në fund informon palen ankuese dhe të akuzuarin për shkresën e rekomanduar dhe kërkon prej tyre brenda shtatë ditëve një përgjigje nga pala e akuzuar e cila mund të jetë:

- a. pranojë rekomandimin nga KI
- b. apelojë për vendimin që është marrë nga KI.

Nëqoftesë ankuesi apelon Kryetari i Komisionit të Incidenteve ingarkuar me sqarimin e ankësë do të procedojë duke e përcjellë atë së bashku me provat e mledhura në një proces gjykimi si më poshtë.

D.Gjykimi nga Keshilli i Etikes

Kryetari i KE njofton palët që të dorëzojnë një shkresë ku të jenë shkruar koha, data, vendi i dëgjimit dhe një kopje të ankësës. Seancat nuk do të zgjasin më shumë se 15 ditë nga skadimi i periudhës së apelimit kundrejt rekomandimit të KI. Gjate seancave ankuesi apo i akuzuari mund të ketë një avokat prezent i cili nuk mund të veprojë si një keshillues për të interesuarin, i cili mund të parashtrojë të gjitha dokumentat apo dëshmitarët në favor të tij.

1. Gjykimi është një proces nga i cili mund të vendos me shumicë votash që mund të ketë ndonjë rekomandim ndaj atij ndaj të cilit është drejtuar ankesa për shkelje të normave të Kodit Etik.
2. Gjykimi duhet të ndahet në dy pista: **a.)** e para një perkufizim që studenti apo i punsuari që në universitet ka shkelur apo jo kodin; **b.)** e dyta një perkufizim për aktin apo gabimin përkatës.
3. I tere Keshilli i Etikes duhet të votojë tek e tek në bazë të pyetjeve që behen dhe një vote mazhoritare vendos që ka pasur një shkelje të normave të Kodit apo duhet dërguar një rekomandim të KE.
4. Në përcaktimin e një faji Keshilli i Etikes mund të marrë parasysh regjistrimet e meparshme disiplinore që mund të ketë marrë studenti apo i punsuari në këtë universitet.
5. Nëqoftesë mazhoriteti i Keshillit të Etikes arrin në përfundimin se nuk përcakton që ka qenë apo jo një shkelje e normave të Kodit të Etikes apo të dërgohet apo jo një rekomandim për personin që shqyrtohet ankesa, nuk do të pasqyrohet ndonjë shenim në dosjen disiplinore të tij.
6. Si studenti apo i punsuari në këtë universitet që shqyrtohet për të cilin është paraqitur ankesa në Keshillin e Etikes të universitetit ashtu dhe avokati apo ndonjë person tjetër mbështetës nuk do të jenë prezent gjatë marrjes së vendimit të komisionit.

Rekomandimet

Çdo konkluzion që arihet pas dëgjimit dhe shqyrtimit të të gjitha provave verbale apo me shkrim nga Keshilli i Etikes që studenti apo i punsuari në universitet ka shkelur Kodin Etik apo akti përkatës duhet të provohet nga KE, dhe do të marrë një vendim, i cili do të pasqyrojë



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

shkelje e Kodit Etik dhe provat qe vertetojne ate. Brenda 10 ditesh nga marrja dijani për të mund te apeloje vendimin e marre tek Dekani i i njesisë kryesore.

Vendimet

1. Dekani duhet të japë vendimin perfundimtar, nese kemi mosrespektim te normave etike te Kodit, ose mund te kerkoje prova te tjera per te ndihmuar ne dhenien e ketij vendimi.
2. Neqoftese Dekani vendos qe nuk ka ndonje mosrespektim të normave etike te Kodit asgje nuk duhet shenuar ne dosjen disiplinore te studentit.
3. Studenti apo i punesuari ne kete universitet, qe ka qene thirur nga Keshilli i Etikes per ankesen qe eshte bere ndaj tij, per shkelje te normave te etikes se Kodit Etik,duhet te informohet mbi vendimin qe ka marre Dekani brenda 10 diteve pasi ai ka apeluar per vendimin e marre nga KE.

Apelimi

Apelimi per vendimin e marre nga Dekani brenda 5 diteve pas daljes se vendimit ,duhet te perfshije ndonje deshmi apo material jo i dhene me pare. Dekani merr nje vendim final pas 10 ditesh pune nga apelimi i ankuesit.

Aktet dhe Gabimet

Aktet dhe gabimet e rekomanduara KE dhe te vendosura nga Dekani duhet te jene te pershtatshme dhe llogjike.

Këto janë:

Këshillimi

Studenti do te keshillohet nga anetaret e Komisionit ose nga persona te tjere te autorizuar nga Komisioni. Keshillimi nuk konsiderohet si nje denim ose faj dhe nuk shenohet ne dosjen disiplinore te studentit. Ai vlen qe t'i paraprihet nje shkelje te normave te Kodit Etik .

Përsëritja e provimit

Studentit do t'i kerkohet te perseritet provimi apo ndonje procedure tjeter ne lidhje me shkeljen e normave te Kodit . Keto mund te shenohen ne dosjen disiplinore te studentit por mund te fshihen pas diplomimit te tij dhe nuk jepen si reference per studentin.

Leter e perkoheshme qortimi

Studenti do te marre nje qortim te shkruar nga Keshilli i Etikes, firmosur nga Kryetari. Nje kopje e saj do t'i bashkangjitet dosjes se studentit. Kjo nuk jepet si reference pas diplomimit dhe fshihet nga dosja vetem nese studentit pas kesaj nuk ka kryer ndonje shkelje tjeter Kodi.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

Shkrese qortimi

Studenti do të marrë një shkrese qortimi nga Komisioni e firmosur nga Kryetari. Kjo i bashkangjitet dosjes dhe i jepet si reference nga shkolla pas diplomimit.

Perseritje semestri

Studentit i kerkohet të perserise semestrin apo vitin neqoftese brenda kesaj kohe ai ka kryer ndonje shkelje te normave te Kodit Etik. Ky akt regjistrohet ne dosjen permanente te studentit dhe i jepet si reference pas diplomimit.

Zhdëmtimi

Neqoftese studenti demton ndonje objekt qe i perket universitetit, ai duhet ta zhdemtoje ate brenda nje kohe te percaktuar. Kjo shenohet ne dosje dhe referohet pas mbarimit te shkollës.

Perjashtimi me mundesi riaplikimi

Studenti pezullohet nga programi dhe mund të lejohet të aplikojë perseri vitin tjetër, por kjo gje shenohet ne dosjen e tij dhe referohet pas shkollës.

Perjashtimi pergjithmone

Studenti pezullohet nga vazhdimi i programit dhe nuk lejohet me të aplikojë ne shkollen tone, i propozohet nga Dekani i njesise mbeshtetur ne nenin 51 të Rregullores së Albanian University.

Neni 21

Publikimi dhe zbatimi kodit te etikes

1. Eshte detyre e universitetit të promovojë perhapjen ne shkalle sa me te gjere to ketij kodi nepermjet publikimeve komunikimeve, takimeve, veprimtarive mesimore dhe çdo mjet tjetër të pershtatshem për kete

2. Universiteti nderhyn menjehere me çdo mjet te konsideruar te nevojshem per zbatimin e ketij kodi ne rastet kur paraqitet nevoja.

REKTORI
PROF.DR. PAVLI KONGO